



MARRËDHËNIET SHQIPËRI - SERBI NË SYTË E PUBLIKUT SHQIPTAR 2015

Alba Cela



Marrëdhëniet Shqipëri - Serbi në sytë e publikut Shqiptar 2015

Alba Cela



Tiranë, 2015

Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung
Office Tirana
Rr. Abdi Toptani
Torre Drin, Kati i 3-të
Kutia Postare 1418
Tiranë, ALBANIA

Autor: Alba Cela

Përkthimi në shqip: Dritan Sulcebe, Sara Kelmendi

*Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në
këtë botim janë të autorit dhe nuk reflektojnë domosodshmërisht
ato të Fondacionit Friedrich-Ebert.*

Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren
për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

Pasqyra e Lëndës

Hyrje	5
1. Përmbledhje.....	9
2. Të dhëna demografike.....	12
3. Gjetjet e detajuara dhe analiza.....	15
3.1 Vlerësime të përgjithshme	15
3.2 Marrëdhëniet politike dhe konteksti European	21
3.3 Ndërveprimi i drejtpërdrejtë dhe shkëmbimet kulturore.....	34
3.4 Marrëdhëniet Ekonomike	38



HYRJE

Ndeshja mes Serbisë dhe Shqipërisë në tetor të 2014-ës kur incidenti famëkeq i dronit ndërseu dhunën ndaj futbollistëve shqiptarë, ka hyrë tashmë në listën e ngjarjeve sportive më të famshme. Kjo gjë ilustron më së miri logjikën e njohur tashmë që futbolli ende mbart në vetvete ndjenja nacionaliste agresive. Fillimisht Shqipëria u dënua nga UEFA si humbëse e ndeshjes, për t'u shpërblyer më vonë nga vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv, e cila i dha fitoren skuadrës shqiptare duke i hequr 3 pikët Serbisë. Luhatjet e retorikave nacionaliste gjatë ndeshjeve të futbollit vijuan edhe në ndeshjen e kthimit të luajtur në Shqipëri ku Serbia shënoi dy herë, duke i lënë tifozët shqiptarë të zhgënjyer. Ndeshja ishte e një shkalle të lartë sigurie duke qenë se qeveria shqiptare kishte marrë masa të ashpra për t'u siguruar që skuadra serbe nuk do të pësonte as incidentin më të vogël gjatë qëndrimit në Shqipëri. Pak ditë më vonë, pasi mundi Armeninë në një ndeshje 3-0, Shqipëria siguroi debutimin e saj historik në Kampionatin Europian të Futbollit që do të mbahet vitin e ardhshëm në Francë.

Megjithëkëtë, do të ishte e gabuar të mendohej se marrëdhëniet dypalëshe midis Shqipërisë dhe Serbisë së fundmi janë të këqija. Incidentet dhe ngjarjet që shënuan këtë vit nuk janë të limituara vetëm në evenimentet sportive dhe nuk janë tërësisht negative. Kryeministri serb dhe ai shqiptar, aktorë kryesorë në samitet e Berlinit dhe të Vjenës, i kanë dalë në krah kancelares Merkel në ngjarjet me rëndësi rajonale dhe në rang europian, duke shfaqur kështu një potencial të jashtëzakonshëm për dialog, madje dhe një

atmosferë shoqërore. Shkëmbimet rinore që do t'i hapin udhën themelimit të një qëndre rajonale rinore, me seli si në Tiranë ashtu edhe ne Beograd, kanë tërhequr vëmendje pozitive mediatike si dhe janë pritur me ngrohtësi nga publiku, pas gjithë negativitetit që televizionet dhe shtypi kanë përhapur gjatë 2014-ës.

Angazhimi për normalizimin e marrëdhënieve dypalëshe nga qeveritë përkatëse është një hap i rëndësishëm, duke mbajtur parasysh të shkuarën e vështirë. Sidoqoftë, që këto përpjekje të rezultojnë të suksesshme, duhen përfshirë dhe segmente të tjera të shoqërisë. Ka ende shumë për të bërë me median e cila shpeshherë përmend tema të diskutueshme ose mite të pavërteta, pavarësisht faktit që këto mund të jenë të pavend në raport me sfidat aktuale me të cilat po përballen këto dy shtete.

Shqipëria dhe Serbia mbartin një bagazh historik të vështirë. Shpërbërja e Jugosllavisë dhe konflikti në Kosovë, si dhe pavaërsia e Kosovës që e pasoi, kanë krijuar luhatje tensionesh të fuqishme për dy vendet që pretendojnë se janë vatrat e grupeve etnike më të mëdha ballkanike. Sidoqoftë, disa shenja normalizimi vihen re edhe midis Serbisë dhe Kosovës – këto falë dialogut të nxitur nga BE që shkon përtej shtrëngimeve simbolike të duarve, por gjer në implementimin e marrëveshjeve dyplëshe.

Ajo çka është më e rëndësishmja është se projektet e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve që njihen prej kohësh dhe që kanë gjetur rrugën e bashkëpunimit në të shkuarën, pavarësisht dallimeve të tyre, janë kthyer tashmë në nisma të përbashkëta të qëndrueshme. Organizatat e shoqërisë civile, kanë marrë përsipër përforcimin e lidhjeve dhe përfshirjen e aktorëve të tjerë në këtë proces, duke shpresuar se maksima “të njohësh tjetrin do të thotë të reshtësh së urreyeri” do të funksionojë. Në këtë kontekst, institutet më të rëndësishme të shoqërisë civile në secilin shtet: Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare dhe Forumi për Marrëdhënie Ndërkombëtare i

Lëvizjes Europiane të Serbisë kanë bashkuar forcat për themelimin e qendrës së përbashkët për marrëdhëniet shqiptaro-serbe që synon promovimin dhe normalizimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, nxit bashkëpunimin dhe bashkëveprimin mes të rinjve, mediave, komunitetit të biznesit dhe mban të gjallë shtysën për bashkëpunim rajonal.

Ky anketim, që ka shërbyer gjithashtu si pikënisje për lançimin e qendrës sonë, është hapi i parë drejt vlerësimit të gjendjes aktuale të marrëdhënieve sipas perceptimit të qytetarëve shqiptarë. Kuadri i perceptimit të qytetarëve është i vlefshëm jo vetëm si një dritare për më shumë informacion mbi vlerësimet, mitet apo keqkuptimet, por gjithashtu edhe si një mënyrë për të matur çfarë pritshmërisë ekzistojnë për të ardhmen e këtyre marrëdhënieve. Matja e pulsit të opinionit publik dhe niveli i përgjithshëm i mbështetjes për përmirësimin (ose mungesën e përmirësimit) të marrëdhënieve, do t'i ndihmojnë vendim-marrësve dhe politikë-bërësve në hartimin e politikave të jashtme efektive, projekteve të bashkëpunimit dhe marrëveshjeve në fushën e ekonomisë dhe bashkëpunimit ekonomik e kulturor. Një tjetër synim i anketës është që ajo të përdoret si mjet referimi nga subjekte të tjera si shoqëria civile dhe aktorët kulturorë për të gjetur rrugë të reja në të cilat mund të zgjerohen mundësitë për bashkëveprim.

Rezultatet e anketës të cilën ju mund ta shfletoni në këtë publikim, paraqesin potencial pozitiv për përmirësimin e marrëdhënieve dypalëshe, që më së shumti do të fillojnë nga “aspektet më të lehta”; bashkëpunimi kulturor dhe thellimi i njohjes me njëri-tjetrin. Ajo çka është më e rëndësishmja, qytetarët janë qartazi të vetëdijshëm mbi rëndësinë që këto marrëdhënie mbartin në të ardhmen e mbarë rajonit, si dhe për projektin e përbashkët të integritimit europian të vendeve të rajonit.

Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare shpreson se publikimi

do të shërbejë në interesin e mirë të atyre që po punojnë mbi normalizimin e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Serbisë, si dhe zhvillimin e marrëdhënieve tërësisht të mira fqinjësore për të ardhmen e përbashkët brenda BE.

Shënim mbi sondazhin

Ky sondazh është zhvilluar gjatë 2014 me 1200 qytetarë shqiptarë nga të gjithë 12 rajonet administrative të Shqipërisë. Metoda e përdorur janë intervistat ballë përballë. Të dhëna mbi profilin e të anketuarve mund të gjenden në sekisonin përkatës *‘Të dhëna demografike të kampionit.’*

1. Përmbledhje

- Shumica e shtetasve shqiptarë besojnë se marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë janë normale, ku 46 përqind të të intervistuarve kanë zgjedhur këtë alternativë, të ndjekur nga një grup i dytë që përfaqëson 36 përqind të cilët besojnë se marrëdhëniet janë të këqija, ose shumë të këqija. Një grup më i vogël, 16 përqind, besojnë se marrëdhëniet janë të mira ose shumë të mira.
- Grupi i njerëzve që besojnë se marrëdhëniet ndërmjet qeverive janë normale është më i madh se 55 përqind, krahasuar me 42.5 përqind të njerëzve që besojnë se marrëdhëniet mes dy popujve, respektivisht serbëve dhe shqiptarëve, janë normale.
- 67.4 përqind i vlerësojnë marrëdhëniet shqiptaro-serbe si të rëndësishme. 86 përqind e shqiptarëve, shumica dërrmuese, besojnë se marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë janë çelësi i stabilitetit dhe sigurisë në mbarë rajonin e Ballkanit.
- Shumë prej shqiptarëve presin që marrëdhëniet me Serbinë të përmirësohen në të ardhmen, ndërkohë që një e treta e tyre mendon se nuk do të ketë ndryshime. 50 përqind e shqiptarëve besojnë se shtetet janë të gatshme për të ndërtuar marrëdhënie miqësore ndërkohë që 30 përqind nuk pajtohen me këtë mendim.
- Vetëm 5 përqind e shtetasve shqiptarë e konsiderojnë Serbinë si një kërcënim për Shqipërinë. Më shumë se 60 përqind e qytetarëve mendojnë se asnjë shtet nuk paraqet kërcënim për Shqipërinë.


- 37.4 përqind e shqiptarëve mendojnë se qeveria e tyre duhet t'i kushtojë vëmendje marrëdhënies me Serbinë, ndër të cilët gjysma cilëson se duhet t'i kushtohet vëmendja e duhur ose mesatarisht.
- Shumica dërmuese e shqiptarëve, rreth 90 përqind, besojnë se Shqipëria dhe Serbia duhet t'i përmirësojnë marrëdhëniet për të mirën e tyre, një përqindje kjo shumë më e lartë se ajo e atyre të anketuarve të cilët vlerësojnë se përmirësimi i marrëdhënieve duhet të ndodhë me kërkesën e Brukselit apo të Berlinit. Gjithashtu, më shumë se 60 përqind e shqiptarëve shprehën se të dy shtetet duhet të zhvillojnë marrëdhëniet dypalëshe, pavarësisht marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë.
- Sipas shqiptarëve, *“armiqësia historike ndërmjet dy kombeve”* si dhe *“shtypja e shqiptarëve të Kosovës dhe trashëgimia kriminale e regjimit të Miloshevicit në Kosovë”* në të shkuarën, janë dy faktorët kryesorë që pengojnë zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe. Në secilin rast, më shumë se 80 përqind prej tyre cilësojnë pikërisht këto arsye ndër pengesat e para ose të dyta më të rëndësishme që duhen kapërcyer me qëllim që të zhvillohen marrëdhëniet. Pengesa të tjera të përmendura nga të anketuarit por të renditura si më pak të rëndësishme janë *“mungesa e komunikimit për një kohë të gjatë midis qytetarëve të Serbisë dhe atyre të Shqipërisë”* si dhe *“niveli i marrëdhënieve ekonomike midis dy vendeve dhe shoqërive”*. Përkatesisht, 41 dhe 13 përqind e përgjigjieve i rendisin këta dy faktorë të tretët për nga rëndësia.
- Vetëm 17 përqind e shqiptarëve kanë udhëtuar drejt Serbisë, çereku prej të cilëve kanë udhëtuar vetëm si tranzit.
- Vetëm 18 përqind e shqiptarëve kanë lexuar libra nga autorë serbë, ndërsa 30 përqind e të anketuarve kanë parë filma regjizorësh të famshëm serbë.

- Shumica e shqiptarëve, pak më shumë mbi 80 përqind, janë në favor të të paturit evente kulturore të përbashkëta me Serbinë.
- Gjysma e qytetarëve që morën pjesë në këtë anketim janë përgjigjur se sipas tyre, Shqipëria dhe Serbia kanë marrëdhënie ekonomike normale, ndërkohë që 21 përqind i cilësojnë ato marrëdhënie si të mira ose shumë të mira. 12 përqind e të të anketuarve i cilësojnë marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve si të këqija ose shumë të këqija.
- Shumica e shtetasve shqiptarë nuk janë në dijeni të produkteve që Shqipëria importon nga Serbia; një e treta e shqiptarëve mendojnë se importet konsistojnë më së shumti në grurë dhe miell. 60 përqind besojnë se Shqipëria është një destinacion turistik për serbët.

2. Të dhëna demografike


Statistikat gjinore tregojnë se 50.8 përqind e personave të anketuar janë meshkuj dhe 48.7 përqind e tyre, femra, ndërkohë që 0.5 përqind preferuan të mos i përgjigjen fare kësaj pyetjeje.

Gjinia




Përsa i përket grupmoshave të të anketuarve: 30.1 përqind i përkasin grupmoshës 35-49 vjec, grupmosha kjo me frekuencën më të lartë të personave që iu përgjigjën kësaj ankete. Me një pjesëmarrje prej 28 përqind, njerëzit që i përkasin grupmoshës 25-34 vjec renditen të dytët. Ndërkohë që të tretët renditen të anketuarit që i përkasin grupmoshës 18-24 vjec, me 27 përqind. Frekuenca më e ulët dallohet në grupmoshën e mbi 60-vjecarëve ku ka patur vetëm 14.8 përqind pjesëmarrje.

Grupmoshat




Mbledhja e të dhënave mbi sfondin akademik të të anketuarve tregon se 47 përqind e tyre janë të diplomuar në nivel universitar. Pas tyre renditen njerëzit që janë diplomuar në nivelin arsimor të mesëm, që përbëjnë 35.3 përqind. Përqindja e të diplomuarve në sistemin pasuniversitar është 8.3. 7.2 përqind e pjesëmarrësve në këtë anketim kanë mbaruar vetëm ciklin e ulët dhe 0.2 e tyre refuzuan t'i përgjigjeshin kësaj pyetjeje. Ndërsa frekuenca më e ulët e të të anketuarve dallohet në grupin e njerëzve të paarsimuar ku vetëm 0.6 përqind kanë marrë pjesë në këtë ankete dhe 1.3 përqind kanë përfunduar vetëm ciklin fillor.

Niveli arsimor



Grafiku i fundit tregon statusin e punësimit të të anketuarve. Përkundër 17.8 përqind të tyre që janë të papunësuar, 45 përqind janë të punësuar. Të vetëpunësuarit përbëjnë 17.3 përqind, ndërsa studentët 11.7 përqind të njerëzve që kanë marrë pjesë në këtë anketim. Vetëm 0.2 përqind refuzuan t'i përgjigjen kësaj pyetjeje dhe 8 përqind janë pensionistë.

Statusi i punësimit




3. Gjetjet e detajuara dhe analiza

3.1 Vlerësime të përgjithshme


Pavarësisht të qenit dëshmitarë të një viti intensiv të mbushur me incidente dhe vizita të nivelit të lartë ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë, shumica e qytetarëve, pothuajse gjysma prej tyre, ndjente se marrëdhëniet mes dy shteteve janë normale. 45.6 përqind zgjodhën këtë opsion. Një grup i konsiderueshëm që përfaqësonte një të tretat nuk i konsideronte marrëdhëniet normale, me 29.5 përqind që i cilësonte ato si të këqija dhe 5 përqind si shumë të këqija. Rreth 16 përqind e qytetarëve janë në spektrin tjetër të përgjigjeve; 13.4 përqind i cilësonin marrëdhëniet si të mira dhe pak më shumë se 3 përqind e tyre, si shumë të mira.

Si do t'i vlerësonit në përgjithësi marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë?



Të pyetur konkretisht mbi marrëdhëniet ekzistuese ndërmjet qeverive përkatëse të dy vendeve, përgjigjet anonin pak më shumë drejt vlerësimit normal. 54.7 përqind shpreheshin se marrëdhëniet ndërmjet organeve ekzekutive të Shqipërisë dhe të Serbisë janë normale, të ndjekur nga 20.5 përqind që i cilësojnë ato si të këqija ose shumë të këqija. 13,7 përqind e qytetarëve të pyetur mbi këtë çështje u shprehën që qeveritë mbajnë marrëdhënie të mira ose shumë të mira.

Si do t'i vlerësonit marrëdhëniet ndërmjet qeverive të dy shteteve, Shqipërisë dhe Serbisë?




Të pyetur mbi perceptimin e marrëdhënieve ndërmjet dy popujve, vlerësimi mbi marrëdhëniet e shtetasve shqiptarë dhe atyre serbë zbutet në vetëm 42.5 përqind që shprehën se marrëdhëniet janë normale, të ndjekur nga 27.5 përqind që i cilësojnë këto marrëdhënie të këqija dhe 7 përqind, si shumë të këqija. Rreth 14 përqind e atyre që janë pyetur i perceptojnë marrëdhëniet si të mira dhe vetëm 2.6 përqind si shumë të mira.

Duke krahasuar këto dy rezultate është e qartë se sipas perceptimit të përgjithshëm të qytetarëve, qeveritë e tyre përkatëse kanë


marrëdhënie më të mira sesa vetë shtetasit e tyre. Ky ndryshim në perceptim vjen si ndikim i takimeve të nivelit të lartë dhe vizitave që të dy krerët e shteteve kanë bërë si në Shqipëri, dhe në Serbi, por gjithashtu dhe falë takimeve të tyre të përbashkëta nëpër evenimentet e BE. Sic vihet re dhe në anketimin e bërë në vitin 2013 nga AIIS mbi marrëdhëniet shqiptaro-greke, përgjithësisht qytetarët i perceptojnë marrëdhëniet e qeverive të tyre me fqinjët si shumë më të mira sesa vetë marrëdhëniet e tyre.

Bazuar në përvojën tuaj por edhe të komunitetit, si do t'i vlerësonit marrëdhëniet aktuale mes shtetasve të Shqipërisë dhe atyre të Serbisë?



Dy të tretat e shqiptarëve të pyetur, 49.2 përqind e tyre, besojnë se marrëdhëniet me Serbinë mbartin rëndësi të veçantë dhe 18.2 përqind i vlerësojnë si shumë të veçanta. Në krahasim më një të katërtat, 25.6% që besojnë se nuk janë dhe aq të rëndësishme, një grup i vogël prej 4.5 përqind i vlerëson këto marrëdhënie si aspak të rëndësishme.


Sipas gjykimit tuaj, sa të rëndësishme janë marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë?



Të pyetur mbi pritshmëritë e së ardhmes, shumica e të anketuarve u shprehën se besojnë që marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë do të përmirësohen. 54.4 përqind shprehen se përmirësimi do të kthehet në trend, krahasuar me 32.1 përqind, sipas të cilëve gjendja do të mbetet e pandryshueshme dhe një grupi të vogël prej 3.3 përqind që presin përshkallëzim të marrëdhënieve. Një numër i konsiderueshëm i personave që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje, rreth 10 përqind, nuk kanë zgjedhur një opsion të vlefshëm.


Si do të jenë marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë në të ardhmen?

Shtetasit shqiptarë janë të vetëdijshëm mbi rëndësinë që mbartin marrëdhëniet dypalëshe me Serbinë për mbarë rajonin. Për rrjedhojë shumica prej tyre i cilëson këto marrëdhënie si çelës për sigurinë dhe paqen në Ballkanin Perëndimor. 34 përqind e qytetarëve shprehen se marrëdhëniet janë shumë të rëndësishme në këtë kontekst, të ndjekur nga 52 përqind që i cilësojnë si të



rëndësishme. Një në dhjetë të anketuar (10 përqind) nuk beson se marrëdhëniet dypalëshe me Serbinë janë të rëndësishme për stabilitetin në rajon.


Sa të rëndësishme janë marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë për sigurinë dhe stabilitetin në Ballkan?



Të pyetur mbi perceptimet dhe gatishmërinë për ta lënë pas historinë dhe për të përgatitur marrëdhënie më të mira në të ardhmen, shqiptarët janë të ndarë; 50,7 përqind duket se janë të mendimit se të

dy shtetet janë të gatshme për të ndërtuar marrëdhënie miqësore, të ndjekur nga 30.1 përqind që nuk pajtohen me këtë mendim. Numri i qytetarëve që kanë preferuar mos t'i përgjigjen kësaj pyetjeje është shumë i lartë, mbi 19 përqind. Ky është një tregues që ata janë konfuzë kur bëhet fjalë për nivelin e gatishmërisë për të ndërtuar marrëdhënie më të mira.

A mendoni se të dy vendet janë të përgatitura për të ndërtuar marrëdhënie miqësore?





3.2 Marrëdhëniet politike dhe konteksti European

Shumë shqiptarë, 65.3 përqind mendojnë se Shqipëria nuk është e kërcënuar nga ndonjë shtet tjetër. Ata që besojnë se një rrezik i tillë është i pranishëm, përbëjnë më pak se 20 përqind të të intervistuarve. Një numër i konsiderueshëm i përgjigjjeve, 15.3 përqind tregojnë se qytetarët nuk kanë një përgjigjie për këtë pyetje. Nga 19.4 përqindëshi që beson se Shqipëria është e kërcënuar, vlerësimet se cili shtet përbën një kërcënim variojnë. Nga kjo nënkategori, 31.6 përqind përmendin fqinjin jugor, Greqinë, të ndjekur nga 27.8 përqind që përmendin Serbinë si kërcënim të mundshëm. Shifrat e tjera janë më të ulëta për Rusinë dhe për shtetet Arabe, përkatësisht me 15 dhe 12 përqind. Duke kombinuar rezultatet e dy grafikëve, rezulton se vetëm një total prej 5.4 përqind i të gjithë të anketuarve e cilësojnë Serbinë si kërcënim për Shqipërinë. Prevalenca e Greqisë mbi Serbinë si kërcënim potencial (pavarësisht zgjedhjes nga një numër i ulët i të të anketuarve) është në përputhje me rezultatet e anketimit të AIIS në 2013.¹

A mendoni se Shqipëria kërcënohet nga një shtet tjetër? Nëse po, cili nga shtetet e mëposhtme paraqet kërcënimin më të madh për Shqipërinë:

Shtetasit shqiptarë besojnë se si një prej shteteve fqinje në rajon, qeveria e tyre duhet t'i kushtojë vëmendje marrëdhënieve me Serbinë. Sic tregojnë dhe anketat vjetore të AIIS, shqiptarët e rezervojnë më së shumti vëmendjen e tyre të dëshiruar për fqinjë

1. 'Albanian-Greek relations from the eyes of the Albanian Public 2013' Albanian Institute for International Studies, <http://www.aiis-albania.org/?q=reports>



si Italia, Kosova dhe Greqia. Kjo është mëse e natyrshme duke qenë se lidhjet ekzistuese të Shqipërisë me këto vende mbeten të forta. Në rastin e Serbisë të paktë janë ata që besojnë se qeveria shqiptare nuk duhet t'i kushtojë, ose t'u kushtojë fare pak vëmendje zhvillimit të marrëdhënieve me Serbinë; shifrat e nënvizuara me blu i korrespondojnë një shkalle minimale vëmendjeje 1-3 (zero ose vëmendje minimale). Në anën tjetër të spektrit, numri i qytetarëve që kërkojnë vëmendje maksimale (shkalla 8-10) në marrëdhëniet me Serbinë është më i lartë se 37.4 përqind. Shumica e qytetarëve

të pyetur kanë preferuar që niveli i vëmendjes që i duhet kushtuar marrëdhënieve me Serbinë të jetë mesatar ose i konsiderueshëm (shkalla 4-7), me një total përgjigjesh që mbulon 49.5 përqind.

Tabela 1 : Në një shkallë nga një në dhjetë sa vëmendje duhet t'i kushtojë qeveria shqiptare marrëdhënieve me shtetet fqinje nga rajoni?

Shkalla e vëmendjes	<i>Greqia</i>	<i>Italia</i>	<i>Serbia</i>	<i>Ish Republika Jugosllave e e Maqedonisë</i>	<i>Kosova</i>	<i>Mali i Zi</i>	<i>Turqia</i>
1	3.3	1.5	6.9	2.2	2.0	1.2	2.5
2	2.3	1.0	3.1	2.5	.8	1.7	2.1
3	2.4	.9	3.0	2.7	.8	2.4	2.1
4	2.5	1.3	6.9	4.2	1.1	4.0	3.1
5	7.2	2.6	12.0	14.4	2.3	9.1	5.7
6	7.6	2.5	13.3	11.8	2.4	13.2	5.9
7	17.1	9.5	17.3	21.9	3.6	19.4	10.1
8	20.8	17.1	16.4	16.7	8.2	23.1	16.9
9	12.8	22.6	8.2	11.0	15.8	11.8	23.4
10	24.0	41.0	12.8	12.6	63.1	14.2	28.1
Total	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Të anketuarve iu paqartë një listë me çështje të mundshme që mund të përbëjnë pengesa dhe sfida në ndërtimin e marrëdhënieve normale ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë dhe iu kërkuar t'i rendisin ato sipas perceptimit të tyre të rëndësisë.

Sic dallohet nga rezultatet e tabelës 2 çështjet të përmendura më shpesh dhe pengesat lidheshin me të shkuarën dhe historikun e dy shteteve që përfshinin marrëdhëniet e tyre në konfliktin e Kosovës. Shumica dërmuese e shqiptarëve, 86.2 përqind prej tyre, besojnë se shtypja e shqiptarëve të Kosovës dhe trashëgimia kriminale e regjimit të Milosheviçit në Kosovë përbëjnë pengesa të mëdha në zhvillimin normal të marrëdhënieve dypalëshe. Shqyrtimi i mëtejshëm i tabelës 3 nxjerr në pah se ky faktor renditet i pari ose i dyti, i vlerësuar si problemi më i vështirë për t'u përballur.

Armiqësia historike ndërmjet dy kombeve, një koncept i lidhur në masë të madhe me Kosovën por jo vetëm, është zgjedhur nga 83 përqind e të anketuarve dhe renditet kryesisht si çështje e rëndësishme, pra në vendin e parë ose të dytë.

Gjendja aktuale e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë nuk cilësohet si e kënaqshme nga qytetarët duke qenë se 74 përqind e tyre mendojnë se kjo përbën problem në zhvillimin e marrëdhënieve. Ky rezultat është konfuz po të marrim parasysh që në fillim, shumë prej të anketuarve zgjodhën t'i përshkruajnë marrëdhëniet si normale. Megjithatë, incidentet e kohëve të fundit të lidhura me ndeshjen e futbollit mund të japin kontekstin e duhur për të kuptuar këtë vlerësim kundërshtues.

Sipas perceptimit të 41.2 përqind të qytetarëve, mungesa e komunikimit për një kohë të gjatë mes qytetarëve të Shqipërisë dhe atyre Serbisë është një pengesë e konsiderueshme. Rreth 13 përqind përmend gjithashtu si problematikë që duhet adresuar dhe nivelin e marrëdhënieve ekonomike. Vetëm 0.8 përqind zgjodhën të thonë që nuk ka problematika apo pengesa.

Mungesa e komunikimit ndërmjet shoqërive dhe gjendja e marrëdhënieve ekonomike janë të renditura në vendin e tretë për nga rëndësia nga qytetarët që kanë zgjedhur të përmendin pikërisht këto si pengesa, duke minimizuar kështu rëndësinë e problemeve të trashëguara nga e shkuara që janë më të lidhura më çështjen.

Të anketuarit u njohën me një listë të çështjeve më potenciale, të cilat mund të përbëjnë pengesa dhe sfida për ndërtimin e një marrëdhënieje normale midis Shqipërisë dhe Serbisë dhe gjithashtu iu kërkua për t'i renditur ato sipas rëndësisë së perceptuar.

Siç shihet nga rezultatet në tabelën 2 pengesat dhe çështjet më shumë të përmendura kanë lidhje me të kaluarën dhe historinë konfliktuale mes dy vendeve, si dhe Kosovën. Pjesa dërmuese e shqiptarëve,

86,2%, mendon se shtypja e shqiptarëve të Kosovës dhe trashëgimia kriminale e regjimit të Slobodan Milosheviçit në Kosovë, përbën një pengesë madhore në zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të dyanshme. Për më tepër, nga analiza e të dhënave të tabelës 3, del se kjo çështje është renditur ose si e para ose si problemi i dytë më i rëndësishëm për t'u përballur.

Armiqësia historike mes dy kombeve, një koncept i lidhur më së shumti me Kosovën por edhe më tej, është zgjedhur nga 83% e të anketuarve dhe është renditur përsëri si çështja e pare ose e dytë më e rëndësishme.

Gjendja e marrëdhënieve aktuale mes Shqipërisë dhe Serbisë, po ashtu nuk duket të jetë shumë e kënaqshme për qytetarët, përdherisa 74 për qind e tyre besojnë se kjo përbën një problematikë në zhvillimin e këtyre marrëdhënieve. Ky rezultat është i çuditshëm, pasi që në fillim shumica e të anketuarve zgjedhën për të përcaktuar këto marrëdhëniet si normale. Megjithatë, incidentet e kohëve të fundit të lidhura me ndeshjen e futbollit, mund të ofrojnë edhe kontekstin e nevojshëm për të kuptuar këtë vlerësim të diskutueshëm.

Qytetarët e perceptojnë mungesën e komunikimit për një kohë të gjatë midis qytetarëve shqiptarë dhe serbë si një pengesë të konsiderueshme dhe ky opsion është zgjedhur nga 41.2 për qind e kampionit. Rreth 13 për qind e të anketuarve gjithashtu përmendën nivelin e marrëdhënieve ekonomike, si një çështje që duhet adresuar. Vetëm 0.8 për qind e kampionit zgjodhi opsionin se nuk ka çështje të tilla ose pengesa të tjera të kësaj natyre .

Si mungesa e komunikimit ndërmjet shoqërive ashtu edhe gjendja e marrëdhënieve ekonomike janë vendosur kryesisht në vendin e tretë për nga rëndësia nga të anketuarit, që zgjedhën për t'i përmendur ato si pengesa duke zvogëluar kështu rëndësinë e këtyre problemeve në krahasim me çështjet e trashëguara nga e kaluara, të cilat kanë më shumë peshë.

Tabela 2: Cilat janë tri çështjet më të rëndësishme që përbëjnë pengesa dhe probleme në marrëdhëniet Shqipëri-Serbi (rendisni sipas rëndësisë me numrat 1-3)?

Çështjet	Përqindja (e totalit)
Armiqësia historike midis dy kombeve	82.9
Shtypja e shqiptarëve të Kosovës dhe trashëgimia kriminale e regjimit të Slobodan Milosheviçit në Kosovë	86.2
Gjendja e marrëdhënieve aktuale midis Serbisë dhe Kosovës	74.0
Mungesa e komunikimit për një kohë të gjatë midis qytetarëve nga Serbia dhe Shqipëria	41.2
Niveli i marrëdhënieve ekonomike midis dy vendeve dhe shoqërive	12.8
Nuk ka probleme	0.8

Kur renditen sipas rëndësisë, rezultatet specifike për secilin faktor të përmendur janë:

Nga grupi i përgjigjeve, që zgjodhën armiqësinë historike si çështje / pengesë, 47.1 përqind mendojnë se është çështja më e rëndësishme, 25.2% e dyta më e rëndësishme dhe 27.6% si çështja e tretë më e rëndësishme.

Nga ata që e përmendin shtypjen e shqiptarëve të Kosovës dhe regjimin kriminal të Millosheviçit, 42.1 për qind e shohin atë si çështjen e parë më të rëndësishme pasuar nga 41.8 për qind që e konsiderojnë atë si çështjen e dytë më të rëndësishme dhe 16,2 për

qind si çështjen e tretë më të rëndësishme.

Gjendja aktuale e marrëdhënieve mes dy vendeve u zgjodh edhe nga një nëngrup i konsiderueshëm i kampionit, prej të cilëve 23.3 për qind e vendosin atë në vendin e parë për nga rëndësia, 34.1 në vendin e dytë dhe 42.6 në vendin e tretë.

Nga grupi më i vogël i qytetarëve që flasin për mungesën e komunikimit, 17 për qind e shohin atë si problemin e parë, 28 për qind si të dytin dhe grupi më i madh me 54 për qind të përgjigjeve në atë nënkategori, e shohin atë si pengesën e tretë më të rëndësishme për marrëdhëniet dypalëshe.

Së fundi nga nëngrupi, që përmend marrëdhëniet ekonomike apo mungesën e tyre si pengesë të mundshme, shumica e përgjigjeve i cilësojnë këto aspekte si problemin e tretë më të rëndësishëm me 52 përqind të përgjigjeve, ndërsa ata që i vendosin në vend të dytë dhe të tretë janë përkatësisht 25.3 për qind dhe 22.7 për qind.

Tabela 3: Rëndësia relative e çështjeve dhe pengesave të perceptuara

Niveli i rëndësisë	1	2	3
Armiqësia historike midis dy kombeve	47.1	25.2	27.6
Shtypja e shqiptarëve të Kosovës dhe trashëgimia kriminale e regjimit të Slobodan Milosheviçit në Kosovë	42.1	41.8	16.2
Gjendja e marrëdhënieve aktuale midis Serbisë dhe Kosovës	23.3	34.1	42.6
Mungesa e komunikimit për një kohë të gjatë midis qytetarëve nga Serbia dhe Shqipëria	17.8	28.1	54.0
Niveli i marrëdhënieve ekonomike midis dy vendeve dhe shoqërive	25.3	22.7	51.9


Pjesëmarrësit në anketën tonë u prezantuan me një seri deklaratash dhe gjithashtu u pyetën nëse ata i konsideronin ato të sakta apo jo. Ky eksperiment është bërë për të vlerësuar shkallën e miteve, keqkuptimeve dhe paragjytimeve që ekzistojnë tek publiku shqiptar në lidhje me marrëdhëniet me Serbinë.

Nëse marrim në konsideratë historinë moderne të marrëdhënieve të Shqipërisë dhe Serbisë, atëherë vëmë re që këto vende nuk kanë qenë kurrë të përfshira në një konflikt të drejtpërdrejtë. Megjithatë, konflikti i Serbisë me shqiptarët në Kosovë shihet si arsye që më shumë se 50 për qind e qytetarëve të anketuar të mos pajtohen me deklaratën “Shqiptarët dhe serbët kurrë nuk kanë luftuar njëri-tjetrin.” Vetëm 30 për qind e të anketuarve pajtohen me këtë deklaratë.


Kur u pyetën në lidhje me ndeshjen e diskutueshme të futbollit në Beograd, në tetor 2014, ashtu siç edhe pritej shumica e qytetarëve fajësuan Serbinë. Mbi 70 për qind e shqiptarëve ia vënë fajin palës serbe. Për më pak se 3 për qind fajin e ka Shqipëria, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e përgjigjeve, 20 për qind, fajëson si Shqipërinë ashtu dhe Serbinë për atë që ndodhi.

Ju lutem lexoni deklaratat e mëposhtme dhe përgjigjuni nëse i aproveni ose jo:

Shqiptarët dhe serbët nuk kanë luftuar kurrë me njëri – tjetrin



Sipas mendimit tuaj përgjegjësi kryesor për incidentin e ndodhur në ndeshjen e futbollit në Beograd ishte:



Një grup deklaratash provuan gjithashtu të vlerësojnë perceptimet mbi faktorë të ndryshëm që kushtëzojnë zhvillimin e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Serbisë. Media ka propaganduar idenë se marrëdhëniet mes dy vendeve janë duke u përmirësuar, ose do të normalizohen, sepse kjo është diçka e kërkuar nga Bashkimi Evropian (ose në zhargonin popullor nga Brukseli), apo edhe se kjo gjë është kërkuar nga një shtet i fortë anëtar i BE-së, pra Gjermania. Në fakt këto perceptime gjithashtu reflektojnë edhe takimet e Berlinit dhe Vjenës, të cilat ofruan mundësi për përfaqësues të lartë të klasës politike të të dyja vendeve për të përmbushur dhe madje edhe për të aplikuar për projekte rajonale. Një tjetër faktor i rëndësishëm që përcakton procesin e normalizimit të marrëdhënieve, është marrëdhënia e Serbisë me Kosovën. Nga përgjigjet e dhëna në këtë grup të deklaratave, është e qartë se shqiptarët besojnë më shumë se Shqipëria dhe Serbia duhet të përmirësojnë dhe të thellojnë marrëdhëniet e tyre, sepse kjo është në interesin e tyre dhe jo vetëm sepse kjo çështje është kërkuar nga BE-ja. Gjithashtu një shumicë e konsiderueshme e shqiptarëve besojnë se marrëdhëniet mes Serbisë dhe Kosovës nuk duhet të mbajnë peng.


67 për qind e shqiptarëve besojnë se është e vërtetë që Shqipëria dhe Serbia duhet të përmirësojnë marrëdhëniet e tyre për t'ju përgjigjur një kërkesë nga Bashkimi Evropian, ndërsa 23.5 nuk pajtohen me këtë deklaratë. Pak më shumë se 9 për qind nuk do të komentojnë mbi këtë çështje.

Vetëm 43 për qind e shqiptarëve besojnë se është e vërtetë se marrëdhëniet duhen normalizuar për të plotësuar një kërkesë të Gjermanisë, ndërsa 40 për qind nuk pajtohen. Rreth 17 për qind nuk e dinë ose nuk komentojnë deklaratën. Të dhënat tregojnë se qytetarët janë më të prirur të besojnë se kërkesa për normalizimin e marrëdhënieve mund të vijë nga institucionet e BE-së, sesa nga një shtet anëtar si Gjermania.


90.6 e shqiptarëve besojnë se normalizimi është në interes të të dyja vendeve, ndërsa vetëm 5.7 për qind nuk pajtohen me këtë deklaratë.

61.3 për qind e shqiptarëve besojnë se Shqipëria dhe Serbia duhet të thellojnë marrëdhëniet e tyre, pavarësisht nga marrëdhëniet e Serbisë me Kosovën, ndërsa 28.5 për qind nuk janë dakord me këtë, duke vënë normalizimin e marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës, si kusht për marrëdhëniet dypalëshe me Serbinë. Një nga dhjetë të anketuar nuk kanë bërë vlerësime apo komente mbi këtë deklaratë.


Shqipëria dhe Serbia duhet t'i thellojnë marrëdhëniet sepse këtë e kërkon BE




Shqipëria dhe Serbia duhet t'i përmirësojnë marrëdhëniet, sepse këtë e kërkon Gjermania



Shqipëria dhe Serbia duhet t'i thellojnë marrëdhëniet e tyre, sepse kjo është në interes të të dy vendeve



Shqipëria dhe Serbia duhet t'i thellojnë marrëdhëniet midis tyre, pavarësisht marrëdhënieve të Serbisë me Kosovën




Platforma e integritimit në BE nuk shërben vetëm si rrugë drejt normalizimit dhe bashkëpunimit rajonal në rajon. Shpesh parimi i garës për anëtarësim, gjeneron konkurrencë midis vendeve dhe rivalitetet midis qytetarëve. Aktualisht Serbia, e cila ndërkohë i ka hapur negociatat me BE është një hap përpara Shqipërisë, ndërsa Shqipëria është ende në pritje për një datë për hapjen e negociatave. Megjithatë, nga ana tjetër Serbia ka përpara një kapitull të vështirë për të negociuar, atë të dialogut me Prishtinën, i cili do të negociohet paralelisht me përpjekjet e saj të tjera integruese. Prandaj dinamika e integritimit ofron një pasqyrë interesante mbi nivelin e perceptimit të qytetarëve shqiptarë. Të pyetur nëse ata besojnë se Serbia do të bashkohet me BE përpara Shqipërisë, 41 për qind nuk pajtohen pasi besojnë se Shqipëria do të integrohet më parë. Megjithatë, 30 për qind besojnë se Serbia do të bashkohet me BE përpara Shqipërisë, ndërsa një pjesë e konsiderueshme prej 29 për qind nuk e dinë, ose zgjedhin të mos përgjigjen.


Shumica e shtetasve shqiptarë nuk e dinë nëse qytetarët serbë do të mirëprisnin ose do të inkurajonin anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Për këtë arsye për deklaratën “Qytetarët serbë nuk e dëshirojnë anëtarësimin e Shqipërisë në BE” , 41,4% e të anketuarve u përgjigj me “nuk e di”.

Pothuajse një numër i barabartë i të anketuarve 30 dhe 28.4 për qind përkatësisht, pajtohen ose jo me deklaratën duke sinjalizuar kështu një konfuzion lidhur me perceptimin e reagimi të Serbisë në përpjekjet e Shqipërisë për t’u anëtarësuar në BE.

Serbia do të anëtarësohet në BE përpara Shqipërisë:



Qytetarët serbë nuk e dëshirojnë anëtarësimin e Shqipërisë në BE



3.3 Ndërveprimi i drejtpërdrejtë dhe shkëmbimet kulturore

Niveli i ndërveprimit dhe njohuritë për njëri tjetrin dhe sidomos njohuritë mbi kulturën dhe bashkëpunimin midis dy vendeve, kanë një ndikim të lartë në perceptimet mbi njëri-tjetrin dhe në vlerësimin e mundësive për përmirësimin e marrëdhënieve. Përmes një grupi pyetjesh, anketa kërkon të paraqesë një vështrim të përgjithshëm mbi shkallën e kontakteve të shtetasve shqiptarë me Serbinë, nëpërmjet udhëtimeve ose kulturës së saj (letërsi dhe kinema).


Vetëm 17 për qind e të anketuarve kishte udhëtuar ndonjëherë në Serbi, ndërsa 83 për qind nuk kishte qenë kurrë atje. Nga njerëzit, të cilët kishin udhëtuar në Serbi shumica e tyre, 29.5 për qind, kanë qenë atje për qëllime turistike, ndërsa 23.8 për qind kanë qenë aty vetëm duke kaluar drejt në një tjetër destinacioni. 13 për qind kanë qenë atje për udhëtimet e biznesit, ndërsa 19 për qind për të marrë pjesë në seminare të ndryshme dhe konferenca. Rreth 12.4 për qind kishte udhëtuar për në Serbi për t'u takuar me të afërmit ose miqtë. Nga të dhënat shohim se shumë pak shqiptarë kanë udhëtuar për në Serbi në mënyrë të tillë që mund t'i lejonte ata të kishin ndërveprim dhe njohje të vërtetë me vendin dhe njerëzit (meqenëse tranziti nuk mund të llogaritet në këtë grup). Hapja e një linje direkte fluturimi midis Tiranës dhe Beogradit ka lehtësuar udhëtimin që prej vitit 2014 dhe pritet të ketë një ndikim pozitiv në rritjen e numrit të qytetarëve që njihen me Serbinë.

Rreth 18 për qind e qytetarëve shqiptarë kanë lexuar libra nga autorë serbë, ndërsa 79 për qind thonë se ata kurrë nuk kanë lexuar libra kë këtyre autorëve. Siç është shpjeguar nga shkrimtarë të të dyja palëve, ka pak përkthime cilësore të letërsisë të të dy vendeve në gjuhët përkatëse. Kjo gjë vërehet më shumë në përkthimin e librave të letërsisë bashkëkohore


dhe kjo është një fushë ku mund të ndërhyhet duke mbështetur përkthimin e librave të autorëve serbë në shqip dhe anasjelltas.

Nga ana tjetër, një përqindje e madhe e qytetarëve, 30 për qind, ka parë filma të regjisorëve serbë, disa prej të cilëve janë të njohur si në Shqipëri ashtu dhe në të gjithë rajonin. 56 për qind e qytetarëve nuk kanë parë ndonjëherë filma serbë.


A keni udhëtuar ndonjëherë në Serbi?




Nëse po cilat kanë qenë motivet?



A keni lexuar libra nga autorë serbë?




A keni parë filma të regjisorëve serbë?




Sa për bashkëpunimin kulturor, potenciali i përmirësimit duket në maksimumin e tij. Edhe pse disa hapa janë ndërmarrë në krijimin e mundësive të njohjes e artit dhe kulturës të të dyja vendeve, qytetarët kanë nevojë për më shumë informacion rreth tyre. Plot 61 për qind e të anketuarve thanë se nuk ishin të informuar për aktivitetet e përbashkëta të bashkëpunimit kulturor. Vetëm 28 për qind thanë se ishin në dijeni të tyre.

Shumica dërrmuese pre 81% e të anketuarve, janë shprehur pro mundësive të tjera të bashkëpunimit kulturor dhe vetëm 12 për qind nuk e kërkojnë këtë gjë.

A jeni në dijeni për zhvillimin e aktiviteteve kulturore të përbashkëta midis Shqipërisë dhe Serbisë?



A duhet të organizohen aktivitete të përbashkëta kulturore midis dy vendeve?




3.4 Marrëdhëniet Ekonomike


Së fundmi bashkëpunimi ekonomik, shkëmbimet tregtare dhe aktivitetet e biznesit janë një fushë intensive e ndërveprimit. Vlerësuar nga perceptimet e qytetarëve mbi potencialin e ndërveprimit ekonomik mes Shqipërisë dhe Serbisë, nxirren këto rezultate: Gjysma e kampionit, rreth 51.5 për qind e qytetarëve besojnë se marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve janë normale, 18.2 për qind mendojnë se janë të mira dhe 2.9 për qind mendojnë se ato janë shumë të mira. Në anën tjetër 10.8 për qind mendojnë se marrëdhëniet ekonomike mes të dy vendeve janë të këqija dhe 1.3 për qind shumë të këqija. Më shumë se 15 për qind nuk janë përgjigjur ose thanë se nuk e dinë.

Shumica e shqiptarëve kur u pyetën, nuk e dinin se cilat janë importet e vendit të tyre nga Serbia dhe 39.2 për qind e tyre nuk mundën të japin një përgjigje specifike. Grupi më i madh prej 34.4 për qind, beson se Shqipëria importon nga Serbia grurë dhe miell. Një pjesë prej 15.6 për qind besojnë se Shqipëria importon artikuj ushqimorë të përpunuar, ndërsa 7.2 për qind mendojnë se Shqipëria importon mallra industriale. Grupe të vogla prej 2.3 dhe 1.3 për qind, përmendin tekstile apo artikuj të tjerë importi.

Si do t'i vlerësonit marrëdhëniet midis dy vendeve në fushën ekonomike?



Në dijeninë tuaj çfarë importon Shqipëria nga Serbia?



Kur u pyetën mbi Shqipërinë si destinacion turistik për qytetarët serbë, shqiptarët e pranojnë një deklaratë të tillë. 60 përqind besojnë se Shqipëria është një destinacion turistik për serbët, ndërsa 20 përqind e mohojnë diçka të tillë. Një grup i madh prej 20 përqind, nuk e dijnë ose nuk pranojnë t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Në dijeninë tuaj a është Shqipëria një destinacion turistik për vizitorë nga Serbia?

